

Nr. 7042/Prot

Fier më, 23 / 06/2025

#### PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 23.06.2025. Sot në sallën e mbledhjeve ora 14:00. Të pranishëm në mbledhje 37 këshilltarë.

Znj.Fatbardha Merkaj

Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse kuorumi është arritur.

### Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës.

Znj.Fatbardha Merkaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithëvë në mënyrë elektronike. Kështu që hedhim ne votim rendin e ditës pa shtesat. Më pas do të miratojmë edhe shtesat. Kush është dakort ?

Z.Endri Jaupaj

Pro për pikat e rendit të ditës por jo për shtesat. Shtesat nuk lejohen, jemi në shkelje të rregullores dhe të ligjit. Absolutisht asnjë shtesë.

Znj.Fatbardha Merkaj

Ta hedhim njëherë në votim.

Z.Endri Jaupaj

Nuk ke se çfarë të hedhësh në votim kur është në shkelje të ligjit dhe të rregullores.

Znj.Fatbardha Merkaj

Miratohen pikat e rendit të ditës.

Pro 37 vota.

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Miratohet me të gjitha votat pro.

Znj.Fatbardha Merkaj

Kalojmë në miratimin e pikës shtesë "Për miratimin në parim të kërkesës së Shoqatës Sportive të Futbollit «Eagles Football Club» për dhënien në përdorim në funksion të aktiviteteve sportive, të pasurisë "fushë sporti", ZK 3015 me sipërfaqje 10 100 m², ndodhur në fshatin Pojan Njësia Administrative Dërmënas Fier, pronë e Bashkisë Fier".

Arriva Arriva

Section 1

Pro 35 vota.

Kundra 2 votë

Abstenim s'ka

Miratohet pika shtesë e rendit të ditës.

## Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.05.2025

Znj.Fatbardha Merkaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18.04.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Pro 35 vota.

Kundra 1 votë

Abstenim I votë.

Miratohet.

### Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %,për muajin MAJ 2025"

Znj.Fatbardha Merkaj

Kush e do fjalën nga administrata?

Znj. Merita Bitri

Për muajin Maj propozohen të futen në skemën e ndiihmës ekonomike 2 famijlje

1.Klarita Jorgji Ballabani

Nj.Adm. Nr.1

Gjendje e dobët ekonomike

2. Eleni Thanas Nako

NjAdm. Qendër

Gjendje e dobët ekonomike

Hiqen nga Ndihmë Ekonomike gjithësej\_2 familje.

1. Nevro Maliq Ibrahimi

NjAdm. Qendër

Do aplikoje system

2. Teuta Levend Alushi

NjAdm. Qendër

Do aplikoje system

Gjithësej <u>48</u> familje me një fond prej <u>221,717 (dyqind e njezete e nje mije e shtateqind e shtatembedhjete )lekë.</u>

Z.Elvi Daka

Unë mendoj se nuk ka ndonjë paqartësi në këtë gjë sepse dy familjet e dala i përkasin njësisë Qëndër.Është mbledhur komisioni dhe i ka vlerësuar, kështu që çdo gjë është në rregull.

\_ 2

Znj.Fatbardha Merkaj

Kush është dakort?

Pro 37 vota

Kundra s'ka

Abstenim s'ka

Të gjithë pro, miratohet.

# Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për Miratimin e Projekt Dokumentin të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2026-2028 të Bashkisë Fier", Faza e I

Znj.Fatbardha Merkaj

Të flasi përfaqësuesja e bashkisë.

Znj. Eleni Gjikondaj

Përshëndetje të gjithëve. Ashtu sikurse jeni në dijeni, Siç kemi miratuar dhe më parë, vlerësimin e të ardhurave në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit për të ardhurat vendore, kemi miratuar tavanet përgatitore për vitet 2026-2028, tani miratohet faza 1 e projekt buxhetit 2026-2028, pasi ka dalë dhe udhëzimi për miratimin e projekt buxhetit për vitet 2026-2028. Si burime financimi,nga të ardhurat tona që janë miratuar, kemi transfertën sektoriale dhe transfertën e pakushtëzuar e cila ka ardhur në bazë të udhëzimit dhe këto shpërndahen në bazë të kërkesave buxhetore dhe dëgjesave që bëjmë me publikun. Kemi bërë shpërndarjen sipas programeve. Risi është që këtë radhë, kemi 8(tetë) programe nga 13(trembëdhjetë) që kemi patur në vitet e kaluara.Ka një reduktim nga Ministria e Financave pasi jemi bashki pilot ku do të përfshihemi në projekt buxhet këtë vit. Ndarja sipas programeve është në vlerat, ku jua kemi paraqitur edhe në relacionin e plotë por edhe në atë të shkurtuarin, i cili u është dërguar edhe elektronikisht këshilltarëve. Kush ka pyetje, mund t'ju përgjigjemi.

Z.Armando Subashi

Të nderuar këshilltarë, e keni marrë këtë material?

Z.Eleni Gjikondaj

Materiali u është shpërndarë këshilltarëve.

1 .

### Z.Armando Subashi

Dua të të sqaroj një diçka të vogël. Këto janë disa rregulla financiare, që krahas buxheteve vjetore që miraton këshilli, janë edhe këto buxhetet 3-vjeçare. Ne në fakt këtu kemi miratuar buxhetin 3-vjeçar 2025-2026-2027. Tani rregulli e do që të avancojmë edhe një vit tjetër, pra të fillojmë 2026-2027-2028. Të gjitha këto janë parashikime, se sado që të përpiqemi që të jemi super të saktë me atë që çfarë mund të ndodhi në 2027 apo 2028, askush nuk e parashikon dot, por janë disa parashikime. E rëndësishme është që buxhetet vit pas viti ,kanë një lloj rritje do të thosha me x% në raport me të ardhurat sepse ne nuk mund të pranojmë që viti pasardhës do të mbledhë më pak të ardhura sesa viti parardhës, ashtu sikurse duke u mbledhur më shumë dhe duke u rritur buxheti, sigurisht që rritet edhe pjesa e investimeve. Nqs keni pyetje, ndonjë vërejtje specialistët janë aty për tu përgjigjur

## Z.Kreshnik Dapi

Një vërejtje kam, një sqarim. Edhe ky program, edhe bilanci i konsoliduar, pse vijnë të pafirmosura në këshill? Sepse kështu duket si një dokument i papërfunduar.

Znj.Eleni Gjikondaj

Në fakt këto plotësohen në system, dhe po ta shikoni relacionin që ju është shpërndarë është i nxjerrë nga sistemi, dhe në momentin që do të miratohet në këshill do të dali edhe me firmën tuaj elektronike dhe nuk mundet të firmoset paraprakisht pasi mund të ketë këshillime apo ndryshime të propozuar nga ky këshill. Dhe në momentin që ne ngarkojmë edhe miratimin që merret këtu në këshill, atëherë del relacioni përfundimtarë i firmosur elektronikisht. Drejtuesit e programeve, secili miraton programin e vetë dhe nënshkruan elektronikisht.

Z.Kreshnik Dapi

Firma e grupit që e ka punuar apo personit që e ka konceptuar duhet patjetër.

Z.Armando Subashi

Zonja Gjikondaj po jua sqaron që ky dokument firmoset elektronikisht, pasi kalon në këshill.

Znj. Fatbrdha Merkaj

Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

Mqs ky është një dokument relativisht i rëndësishëm, por është prognoz dhe prognoza ka ato siguri dhe ato pasiguri që korrigjohen në vitet në vijim. Por kam një pyetje. Sa veta e kanë lexuar materialin nga këshilli ?

Z.Armando Subashi

Kjo ndërhyrje është jashtë rendit të ditës.

Z.Ilia Fili

Unë pyetjen nuk e bëj kot, e bëj sepse ky është një dokument relativisht i rëndësishëm dhe nuk dua që të kalojë ky dokument i rëndësishëm vetëm formalisht në këshill. Sepse nesër do të hapet procesverbali dhe do të thonë :Ka kaluar në këshillin e bashisë së Fierit kjo prognozë e analizës financiare pa asnjë diskutim, pa asnjë sygjerim, pa asnjë vërejtje.

Znj. Fatbrdha Merkaj

Ngs do të kishin ndonjë gjë do të flisnin këshilltarët.

Z.Kreshnik Dapi

Zoti Ilia ju e keni lexuar materialin?

Z.Ilia Fili

Po.

Z.Kreshnik Dapi

A

Çfarë ju ka bërë përshtypje?

Z.Ilia Fili

Kur të na japi të drejtën drejtuesja e seancës për të bërë shpjegime, do të jap shpjegimet. Këtu thjeshtë bëra pyetjen. Nqs nuk ka pyetje apo sygjerime nga këshilltarët e tjerë, më lejoni që të vazhdojë të flasë.

Z.Kreshnik Dapi

Aty ka një shifër të frikshëm kryetarë, tek faqja nr...

Znj. Fatbrdha Merkaj

Ju lutem flisni me radhë. Të mbarojë inxhinieri, pastaj merreni fjlën ju Z.Dapi.

Z.Ilia Fili

Ky është një material goxha i bollshëm, goxha i gjerë, ku duket që është punuar por në konstatimin që kam bërë duke lexuar me vëmendje, edhe atë 2025-2027 që përmendi kryetari, kam konstatuar që një pjesë është transfertë nga vitet e mëparëshme, dhe është normale. Por duke parë të tërë materialin nga fillimi deri në fund, më bëri përshtypje pjesa e parë, që slet në përgjithësi për përshkrimin, të cilin unë do tu sygjeroja drejtuesve të bashkisë që kjo pjesë duhet të shkëputet më vete, të përkthehet dhe tu jepet agjensive të turizmit për ta përdorur si reklamë dhe për të treguar se çfarë ofron bashkia e Fierit. Më bën përshtypje duke parë materialin në tërësi, tek të ardhurat dhe shpenzimet, ka një kërcim midis planifikimit të 2025 dhe korrigjimit 2025, madje më vajti mendja tek ato ndryshimet që kemi miratuar ne në lidhje me transfertat e mbartura nga vitet e mëparëshme. Por unë kam sygjeruar edhe në mbledhjen e kaluar por edhe në mbledhjet e tjera, që ka një metodikë e cila pavarësisht se nuk merret në konsideratë nga ana juaj, për planifikin e prognozës.Shikojmë që vlerat e marra nga 2025, hidhet tek 2026, hidhet tek 2027, hidhet tek 2028. Por nuk mund të qëndrojnë këto vlera kaq, pra pa lëvizur nga vendi, kur vetë historiku i viteve parakalues tregon luhatje ose ndryshime. Mgjth kjo është e drejta e autorëve. Më bëjnë përshtypje kërcimet në vlera midis 2024-2025, realisht aty ku planifikohet për 2025, ka një kërcim, një hop të ndjeshëm, që nuk e shikojmë më këtë hov, këtë kërcim, në vitet pasardhës. Ç'farë ka ndodhur midis 2024-2025, që dallohet ky kërcim, qoftë në zërin paga, shpenzime personeli dhe sigurime, qoftë në zërin shpenzimet operative dhe qoftë dhe më pas shkojmë tek shpenzimet kapilare?

## Znj.Eleni Gjikondaj

Po pra e gjithë kjo vjen nga ajo gjëja që thamë, nga vlera e akorduar, sepse 2024 është fakt, kurse 2025 ëshrë plan. Duke qënë se plani u shtua me 900 milion lekë të reja, i bie që normalisht edhe plani i 2025 shtohet me këtë vlerë, prandaj është edhe ajo vlera që ju thoni kërcim nga 2024 në 2025. E gjithë ajo është planifikuar për investime, sepse aty kemi dhe efektin që kanë ndryshuar pagat. Dhe pagat nuk kanë ndryshuar më në të gjitha ndërrmarjet .

## Z.Ilia Fili

Unë mund ta pranoj, të diskutoj të gjitha këto probleme që parashikon prognoza dhe duke qënë se është prognozë nuk kam të drejtë të ngulë këmbë, sepse prognozën varet se si e parashikon ti apo se si e parashikoj unë apo dikush tjetër, por veçanërisht duhet të kemi kujdes në vitin që jemi ekzistues dhe në mënyrë të veçantë me këtë lloj analize të shikojmë parashikimin e 2026 të cilën me siguri ju do të na i sillni shumë

shpejtë. Këto vërejte dhe sygjerime ju lutem ti merrni në konsideratë dhe do tju këshilloja që sidomos programin e vitit 2026 ta shikonit mirë, ta shikoni me kujdes.

Znj. Fatbrdha Merkaj

E hedhim në votim.

Pro 33 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim 2 vota

Miratohet.

# Pika e pestë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin e listës emërore të familjeve të pastreha që përfitojnë banesë me kosto të ulët nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredisë nga buxhet i shtetit nga programi social i subvencionimit të interesave të kredisë për vitin 2025

Znj. Fatbrdha Merkaj

Besoj se komisioni është mbledhur?

Z.Kreshnik Dapi

Po, komisioni është mbledhur gjatë gjithë javës që lamë pas. Në total kanë qënë 79 aplikime nga të cilat 29 kanë qënë përfituese dhe 5 aplikime janë lënë në listë pritje, me qëllim që nëse ndonjë nga përfituesit nuk do ta respektojë afatet dhe nuk do të gjejë banesën sipas kushteve të caktuar, do të futet një prej këtyre aplikimeve që janë në listë pritje. 45 aplikime janë skualifikuar, nga këto 3 familje dokumentacionin e kishin në rregull por e tejkalonin limitin e të ardhurave prej 1 milion lekë të vjetra më shumë se sa është kuota. Për pjesën tjetër aplikimet u shqyrtuan një nga një dhe komisioni votoi pro.

Znj. Fatbrdha Merkaj

E hedhim në votim.

Pro 37 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projekt vendim: Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistuar në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për lidhjen e Kontratave para noterit.

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën nga administrata?

, 0

A second

## Znj.Esmeralda Kapllanaj

Siç është paraqitur edhe në relacion, ky project vendim ju vjen në ndihmë 3 familjeve, të cilët e kanë përfunduar procedurën e privatizimit me ndërrmarjen e Entit të Banesave, por kontratat e privatizimit nuk janë nënshkruar pranë noterit publik. Në momentin që aplikohet në ASHK, sipas ligjit të Kadastrës, këto aplikime duhet të kurorëzoheshin duke nënshkruar kontratën pranë noterit publik. Në këto kushte, qytetarët paraqiten pranë bashkisë Fier për tu ndihmur me një vendimmarrje të këshillit, për të bërë të mundur nënshkrimin e kontratës para noterit, për efekt të verifikimit të dokumentacionit. Bëhet verifikimi i gjendjes familjare midis gjendjes së vitit 92 dhe asaj aktuale, në mënyrë që veprimet të vijojnë me personat sipas vitit, dhe veprimet me ASHK-në të vazhdojnë sipas procedurave ligjore.

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik për pasuritë e paluajtshme pronë private , që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës "Kastriot Muço" Segmenti Kryqezimi me Rrugen "Mujo Ulqinaku"-Kryqëzimi me Unazën "Skëndërbeu" zgjerimi i rrugës" ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik"

Znj.Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën?

Z.Kreshnik Dapi

A ka patur ankesa për ndonjë nga këto procedurat e shpronësimit?

Znj. Esmeralda Kapllanaj

Ky projekt vendim vjen për të mbrojtur të drejtën e pronës së qytetarit. Duke qënë se aty ka një zgjatim të projektit në pjesën fundore, është një sipërfaqe prej 20.7 m, gjithmonë për të respektuar të drejtën e pronës së qytetarit .

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është pro?

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

A . 10

Abstenim s'ka

Miratohet.

### Pika e tetë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik , për pasuritë e paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit "Për vazhdimin e fazës II të Unazës së Cakranit" ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik"

Znj. Antoneta Cunaj

A ka ndonjë këshilltarë që do të sqarohet në lidhje me këtë projekt vendim? Nuk ka. E hedhim në votim.

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

## Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për shpronësim për interes publik, të pasurisë të paluajtshme pronë private. që preket nga realizimi i projektit Rehabilitimi i Lumit Gjanica Faza 3.Fier.

Znj. Antoneta Cunaj

Pika nëtë e rendit të ditës është tërhequr nga ana e administratës për shkak se nuk preket asnjë pronë nga verifikimet që janë kryer në terren.

# Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projekt vendim:"Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve, që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtëshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për zgjerimin i sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak, me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik".

Znj. Antoneta Cunaj

A ka ndonjë këshilltarë që kërkon sqarim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk ka. E hedhim në votim

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

#### Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

1

CO. 1 /

Projekt vendim:"Për miratimin e gjurmës së projektit, planvendosjes së pasurive pronë private që shpronësohen për interes publik, pasuri që preken nga realizimi i e projektit "Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë, "Dua të luaj.'vlerësim paraprak, me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik".

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë këshilltarë që kërkon sqarim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk ka. E hedhim në votim

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për një shtesë pasurie të paluajtshme për shpronësim për interes publik , në kuadër të realizimit të projektit "Rikonstruksioni i Segmentit rrugor "Shën Gjergji -Naun Kaçaku (ish Ura me shkallë -Stacioni i Patosit)", vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , projekt për të cilin është miratuar akti normativ VKM Nr.94 , datë 12/02/2025.

Znj.Antoneta Çunaj

A ka ndonjë këshilltarë që kërkon sqarim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk ka. E hedhim në votim

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

## Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt vendim : "Për miratimin e vijimit të procedurës së dhënies me qira të pasurisë nr. 90/6 zk. 1762 e llojit "tokë bujqësore" me sipërfaqje 45 515 m², ndodhur në fshatin Gjorgoz Njësia Administrative Cakran, Bashkia Fier".

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë këshilltarë që kërkon sqarim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?

Z.Ilia Fili

Unë dua të sqarohem se çfarë është kjo tokë bujqësore dhe mqs nuk e kam parë materialin dhe përse jepet me qera.

Z.Arbion Behari

1

Materiali që ju kemi paraqitur për miratim ka të bëjë me vijimësinë e marrëdhënies juridike të qeradhënies të pasurisë 90/6 zk, pasuri për të cilën nga ana e bashkisë Fier është lidhur një kontratë qeraje. Duke qënë edhe në vijim edhe të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, ku rekomandohet që

9

2

vijimësia e qeradhënies së kësaj pasurie të bëhet përmes miratimit nga ana e këshillit bashkiak. Duke qënë se subjekti që e ka marrë me qera gjatë periudhës së qeradhënies i ka zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata, kemi propozuar vijimin e procedurës së qeradhënies.

#### Z.Ilia Fili

Duke qënë se unë nuk marrë shumë vesh nga këto, por me fjalën tokë bujqësore unë kuptoj një tokë e cila mbillet me prodhime bujqësore, apo jo?

### Z. Arbion Behari

Bashkia ka lidhur një kontratë qeraje me një subjekt i cili e shprytëzon për aktivitet bujqësor nq zbatim të referimeve të lëna nka KLSH-ja, vijimësia e qeradhënies së kësaj kontrate duhet të bëhet pjesë e vendim marrjes së këshillit bashkiak, e kemi sjellë për miratim në këshillin bashkiak këtë projekt vendim.

## Z.Endri Jaupaj

Çfarë ka konstatuar KLSH-ja? Çfarë shkeljesh ka kapur? Si ju ka thënë specifikisht? Çfarë kërkese ju ka bërë?

#### Z.Arbion Behari

Është shrehur që vijimësia e kësaj kontrate dujet të miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Nuk ka patur shkelje thjeshtë ka lënë këtë rekomandim.

## Z.Kreshnik Dapi

Si pjestarë i komisionit, për pikën në fjalë duhet të them nja dy gjëra. Jemi tek pika 13 por e njëjtë është edhe pika 14. Po të shikoni këtu janë dy standarde të ndryshme. Pika 13 në gjykimin tim, mua më duket shumë korrekte, ai qeramarrësi ka ardhur me një kontratë qeramarrjeje, të saktë, të përpiluar, të detajuar me çmimin me afatin e kohëzgjatjes dhe të gjithë të tjerat. Pika e 14 që vjen më poshtë, është pak konfuze dhe e ngatërruar. Mqs jemi afër pikës 14, këto pyetja e kam për atë pikë. Me Arbionin e diskutuam edhe në mbledhjen e komisionit. Kam edhe një vërejtje këtu për këta kolegët këshilltarë. Të dy komisionet, edhe ky i ekonomisë vendore edhe ai i emergjencave civile, ku unë bëjë pjesë, këtë javë kanë dështuar, dmth nuk kanë bërë kuorumin, sepse nuk ka qenë pjesmarrja mbi 4 anëtarë. Ne që ishim prezent, pikat i shqyrtuam. Pika 13 për mua është shumë korrekte.

#### Znj. Antoneta Cunaj

Kreshnik të lutem kalojmë njëherë pikën 13, pastaj plasim për pikën 14.

E hedhim në votim

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e katërmbëdhjetë e rendit të ditës.

 $\bigcap_{i}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{i}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{i}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{i}$   $\bigcap_{j}$   $\bigcap_{i$ 

Projekt vendim: "Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqjeve "tokë pa frut", të ndodhura në fshatin Fushë Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier"

Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën?Po Kreshnik.

### Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, është e disajta herë që vijnë projekt vendime të tilla.Mirë do të ishte që këshilli të kishte informacion të plotë sepse aty në relacionin që kemi ne, kemi vetëm një koment "Sipasojë e disa kërkesave të ardhura" dhe këtu nuk vihet asnjë në dispozicion se cilat kanë qënë kërkesat, sa kanë qënë kërkesat, çfarë kanë ofruar ofertuesit. Të bëhet edhe një analizë nga administrata, që bashkia dhe komuniteti ka interes të ketë më mirë këtë formë përfitimi ekonomik që është qeradhënia, apo me këto toka mund të bëhej diçka tjetër, një veprimtari ekonomike tjetër. Dhe pyetja tjetër sepse harrova dhe ta bëja aty në komision është: Ka patur kërkesa nga komuniteti për këto toka qoftë edhe në formën e dëmshpërblimeve për kthimin dhe kompesimin e pronave?

#### Z.Arbion Behari

Pasuritë që ne kemi paraqitur për miratim në këshillin bashkiak janë të certifikuara të tëra në emër të bashkisë, të cilat mqs nuk ka interes nga bashkia për ti zhvilluar ose nga pushteti qëndror, për ti zhvilluar këto prona, ne mendojmë se qeradhënia e këtyre pasurive dhe pronave sjell të ardhura për bashkinë Fier, do të sjellë mirëmbajtjen e këtyre pronave nga subjektet që mund ta marrin me qera, do të sjellin investime në atë zonë, për këtë arsye propozojmë dhënien me qera të këtyre pasurive. Qeradhënie bëhet me procedurë ankandi, hapet një ankand publik, i ka të përcaktuar kriteret VKM-ja, kush do të japi çmimin më të lartë, në bazë të kritereve të VKM-së do të shpallet dhe fituesi. Këto nuk janë prona që janë subjekt i kthimit dhe i kompesimit të pronave, por këto janë prona të bashkisë Fier.

## Z.Kreshnik Dapi

Ajo që më bën çudi mua është se sipërfqja është goxha e madhe, është gati 20 hektar e ndarë në 4-5 parcela. Pse duhet të vijnë në grup këto? Pse nuk vijnë veç e veç me kërkesat përkatëse ?

#### Z.Arbion Behari

Parcelat janë të ngjitura me njëra tjetrën

### Z.Kreshnik Dapi

Le të jenë, kërkesat janë bërë të përveçme nuk janë bërë në total.

### Z.Arbion Behari

Pavarësisht se nga regjistrimi fillestarë kanë dalë si pasuri më vete, janë sipërfaqe të bashkuara që lidhen me njëra tjetrën, nuk janë sipërfaqe të ndara.

## Z.Kreshnik Dapi

Nga përvoja, këto forma të qeradhënies, janë defakto humbje e pronësisë sepse ai zotëria që do të vijë aty dhe do të bëj investimin aty, me panele apo me diçka tjetër, gradualisht i lind e drejta edhe për ta privatizuar atë.

11 rose M

## Znj. Antoneta Çunaj

Nuk ndodh ajo gjë sepse edhe tjetërsimin e pronës ne si këshill bashkiak do ta bëjmë dhe skemi pse ta bëjmë kur subjekti është qeramarrës.

Z.Kreshnik Dapi

Po forma të tjera përfitimi, keni bërë ndonjë studim, a ka nga këto toka?

Z.Arbion Behari

Nuk ka asnjë lloj forme tjetër përfitimi.

Z.Melsi Bogdani

Po ndonjë qytetarë, i ka patur në përdorim këto toka?

Z.Arbion Behari

Jo

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 35 vota

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka

Miratohet.

### Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Pandeli Nasto, lagjia "16 Prilli", Njësia Administrative nr.4, i dëmtuar nga zjarri i datës 28.05.2025."

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë pyetje nga këshilltarët? Nuk ka. E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 37 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet

### Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Miratimi i dokumentit "Plani Vendor i Emergjencave Civile, bashkia Fier" i rishikuar dhe i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, planin e qarkut dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje sipas kërkesave të nenit nr.14 "Planet për emergjencat civile" të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Znj. Antoneta Cunaj

A ka ndonjë pyetje nga këshilltarët? Nuk ka. E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 35 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim 1 votë.

Miratohet.

## Pikë shtesë e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin në parim të kërkesës së Shoqatës Sportive të Futbollit «Eagles Football Club» për dhënien në përdorim në funksion të aktiviteteve sportive, të pasurisë "fushë sporti", ZK 3015 me sipërfaqje 10 100 m², ndodhur në fshatin Pojan Njësia Administrative Dërmënas Fier, pronë e Bashkisë Fier".

Znj. Antoneta Çunaj

Kush e do fjalën?

Z.Armando Subashi

T'ju them dy fjalë për këtë projekt vendim. Kjo në fakt është fusha që është pjesë e shkollës në Pojan, atje është një zotëri që është mësues fiskulture me mbiemër Përmeti, ka krijuar edhe këtë shoqatën me disa trajnier të tjerë, pjesë e saj është edhe futbollisti i Apollonisë Ron Haxhiaj. E kanë kërkuar këtë fushë realisht pa kundër shpërblim me idenë se duan të bëjnë disa investime vetë. Thelbi i gjësë është që paradite fusha do ti shërbej nxënësve të shkollës, për programet mësimore, por mbasdite me ekipet e moshave që ata mund të kenë ngritur, plus edhe me fëmijët e zonës aty, të vazhdojnë programet e tyre stërvitore. Besoj që është një gjë pozitive, na ndihmon të gjithëve. Në radhë të parë ndihmon pjesën e komunitetit, të fëmijëve. Fakti që do të bëjnë vetë investime rrit përgjegjshmërinë e atyre që e marrin ambjentin, dhe kështu ata do ta ndjejnë si një gjë të tyren dhe do ta mabjnë çdo ditë atë që ti shërbejnë sa më mirë fëmijëve. Kjo është arsyeja që ne e kemi sjellë këtu në këshill dhe për ta miratuar në parim dhënien në përdorim të këtij ambjenti, por edhe për të bërë një përjashtim, duke e dhënë pa kundërshpërblim. Përvojat në fakt janë pozitive, një përvojë e tillë pozitive është fakti që një shoqatër tjetër me disa trajnier kanë bërë investim në Petovë gjë të gjithë ne e kemi parë kur kemi kaluar në atë rrugë, pra tek ekipi Apollon. Çdo vit e kanë përsosur duke shtuar element të rinj dhe sot është kther në një qëndër e rëndësishme për ekipet e moshave. Kështu që po ta shikojmë me këtë sy, mendoj që duhet ta kalojmë sepse i vlen edhe fëmijëve, edhe moshave, edhe sportit edhe futbollit dhe shumë mirë në atë zonën këtej besoj se pas disa muajsh do të kemi një ambjent mjaft të përshtatshëm që ndoshta rritet edhe frekuentimi nga fëmijët jo vetëm të zonës së Pojanit por edhe nga zonat përreth.Kjo është pak a shumë ajo që doja të thoja.

#### Z.Endri Jaupaj

1.

Do të isha për të stimuluar për përdorimin e ambjenteve sportive të shkollës me orare të reduktuara gjatë periudhës së verës për fëmijët e asaj zone. Pasi shikojmë shpesh herë që fëmijët kapërcejnë edhe kangjellat për të luajtur në fushat e shkollave, ata e gjejnë mënyrën për ti përdorur këto ambjente.P do të ishte më mirë po të ishin më të kontrolluara këto ambjete. Mund të gjendet një formulë për të bërë të mundur përdorimin e këtyre ambjenteve me orar të reduktuar sepse fëmijët ngelën përpara celularëve kompjuterave apo poshtë hyrjeve të pallatev, ndërkohë që hapësirat janë.

#### Z.Armando Subashi

Është një gjë që zgjidhet, sepse ne përgjithësisht kemi roje në çdo shkollë, roje nate që thjeshtë ruajnë objektin se nuk kanë se çfarë të bëjnë tjëtër, ruajnë shkollat. I bëjmë një ndryshim të orarit psh mund të fillojnë rreth orës 5-6 mbasdite në periudhën e verës deri nga ora 9 që mund të jenë të hapura për fëmijët dhe pastaj pjesa e natës është pjesë e punës së tij të zakonshme. Mund të bëjmë një urdhër që të jenë të hapura oborret e shkollave, ndërkohë që kemi 7 fusha shkollash që do ti bëhet riveshja me tapet sintetik pasi e kanë infrastrukturën e ngritur plus 6 fushave të reja që do të bëhet nga fillim. Shiko edhe për projektin "Dua të luaj" doja të shtoja dicka. Ne kemi marrë një vendim para dy muajsh në mos gabojë, ku sipas korrespondencës me FSHZH ishte ideja për 10 ha tokë.që ata mendonin se ishte e mjaftueshme nisur nga disa projekte të ngjshme.që kanë bërë në Berat, Korçë, etj.por niur nga fakti që aty kishte ende territor, ata e zgjeruan si projekt edhe me element ndihmës, pra u shtuan edhe dy fusha të tjera, plus pjesa e parkimit që në të tilla raste është një element shumë i domosdoshëm. Dhe propozimim i dytë që na erdhi ishte që veç 10 000 m2, të përfshihej edhe pjesa tetër, e mbetur dhe prandaj e risollëm në këshill.edhe ndryshimin e projektit, por edhe vlerësimin për rreth 18 000 m2 që është gjithë pjesa mbrapa ETC, e cila ti shponësimit. Lajmi i mirë është që vlerën e shpronësimit do ta përballojë Qeveria, sepse ajo mund të shkojë 2 000 000 euro dhe për bashkinë ishte një shifër e papërballueshme. Projekti do të financohet FSHZH dhe është një projekt i plotë, sikurse e kemi sqaruar në mbledhejn e mëparshme. Pak a shumë këto doja të shtoja për këtë pikë. Faleminderit.

Znj. Antoneta Cunaj

A ka ndonjë pyetje nga këshilltarët? Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 37 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur. Ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen!

Ky procesyerbal ka 14 (katërmbëdhjetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Cupa

GIS, SEHA.

Kryetar i Këshillit

Antoneta Cunaj

Endri

Propi Gra. freshuite Des